USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Elsa Haxhija

Bursiste e programit Youth Exchange and Study (YES)

Gjithçka ka filluar me angazhimet e mia si aktiviste dhe vullnetare në organizata të ndryshme rinore. Rrugëtimi im filloi me organizatat joqeveritare Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) dhe Young Men's Christian Association (YMCA) me të cilat akoma bashkëpunoj. Në YMCA kam filluar angazhimin tim si anëtare e programit të Lidershipit 2018, ndërsa me KVRL-në në qershor të vitit 2018 për herë të parë kam mikëpritur një grup të rinjësh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për një javë në qytetin tim në Gjakovë. Këto përvoja fillestare kanë qenë inspirimi dhe frymëzimi im për atë që jam sot.

Pjesa më e mirë ka qenë puna vullnetare, e sidomos kur Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë lansoi platformën https://kosovovolunteers.org ku të rinjtë kishin mundësinë të aplikonin dhe t'i regjistronin orët e punës vullnetare, të cilat njihen zyrtarisht nga kjo Ministri si kontribut pune. Në krah të KVRL-së dhe YMCA-së jam çertifikuar në shumë programe e trajnime për vullnetarizëm në aktivitete të ndryshme. Si rezultat i angazhimit tim, në vitin 2020 jam përzgjedhur si "Vullnetarja e Vitit" nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nga UNICEF-i në Kosovë. Përzgjedhja ime është bërë në bazë të numrit të orëve që kam kontribuar përmes punës vullnetare. Së fundi, kam fituar bursë përmes programit për shkëmbim "Youth Exchange and Study" (YES), ku tani vijoj mësimin në shkollën e mesme Claudia Taylor Johnson High School në Sh.B.A.

E gjithë puna vullnetare dhe përfshirja ime në komunitet përmes programeve të ndryshme kanë qenë një ndihmesë dhe shtysë e madhe për mua. Këto përvoja më kanë përgatitur drejt rrugës për ta fituar bursën e shkollimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

#dikurjashehhajrin #hajri #jashehhajrin

Iniciativa "Dikur ja sheh hajrin" në Gjakovë mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.